

BLESSED INVESTMENT sh.p.k
Pasqyrat Financiare Individuale më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	i-iii
PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA INDIVIDUALE E PERFORMANCËS	2
PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE INDIVIDUALE	5-22



RSM ALBANIA
Rr.Skender Luarasi, sheshi
Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakët e Blessed Investment Sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Blessed Investment Sh.p.k. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën individuale të performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).


Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare individuale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.



- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.


Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 25\2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare individuale, përveç pasqyrave financiare individuale dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2024 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare individuale nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare individuale apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 27 qershor 2025



Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2024

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	21,568,473	217,404,902
Huadhënie ndaj palëve të lidhura	5	312,521,596	358,375,402
Tatime të parapaguara	6	26,407,875	-
Aktive të prodhuara për shitje	7	979,955,387	713,369,771
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura	8	299,073,380	214,913,435
Të tjera të arkëtueshme	9	381,079,485	278,908,078
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,020,606,196	1,782,971,588
Aktivët afatgjata			
Huadhënie ndaj palëve të lidhura	5	1,220,083,316	1,111,735,328
Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje	10	166,779,517	166,864,999
Aktive të mbajtuara për investim	11	205,558,572	201,817,572
Aktive afatgjata materiale	12	175,267,080	184,225,244
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,767,688,485	1,664,643,143
Totali i aktiveve		3,788,294,681	3,447,614,731
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	13	37,912,517	5,619,554
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	306,055,813	216,181,265
Detyrime tatimore	15	1,952,826	3,329,254
Parapagime të marra	16	772,087,133	461,032,753
Të tjera detyrime	17	10,866,411	8,863,706
Hua të marra nga bankat-pjesa afatshkurtër	18	118,279,688	130,432,575
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,247,154,388	825,459,107
Detyrime afatgjata			
Hua të marra nga bankat-pjesa afatgjatë	18	499,559,022	653,908,153
Totali i detyrimeve afatgjata		499,559,022	653,908,153
Totali i detyrimeve		1,746,713,410	1,479,367,260
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	19	7,000,100	7,000,100
Fitime të mbartura		1,961,247,372	1,443,890,658
Fitimi i ushtrimit		73,333,799	517,356,713
Totali i kapitalit		2,041,581,271	1,968,247,471
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,788,294,681	3,447,614,731

Pasqyrat Financiare Individuale të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë aprovuar nga administratori i BLESSED INVESTMENT sh.p.k më 30 prill 2025 dhe janë firmosur si më poshtë.

Ana Lleshi
Ana Lleshi
Administratore

Entela Gjyzari
Entela Gjyzari
Hartuese e Pasqyrave Financiare

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

NIPT: L71423028S

Pasqyra Individuale e Performancës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhurat	20	109,779,119	348,407,208
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		60,857,075	321,137,534
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		48,922,044	27,269,674
Të tjera shpenzime		(36,848,258)	(45,441,533)
Të tjera shpenzime	21	(36,848,258)	(45,441,533)
Shpenzime të personelit	22	(28,872,916)	(16,898,683)
Paga dhe shpërblime		(25,557,264)	(15,034,180)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore / shëndetësore		(3,315,652)	(1,864,503)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(9,823,940)	(10,175,927)
Të ardhura të tjera		61,102,183	372,421,316
Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	23	61,102,183	372,421,316
Shpenzime financiare	24	(19,522,800)	(105,155,200)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		30,294,304	(23,041,314)
Shpenzime të tjera financiare		(49,817,104)	(82,113,886)
Fitimi/humbja para tatimit		75,813,388	543,157,181
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(2,479,589)	(25,800,468)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	25	(2,479,589)	(25,800,468)
Fitimi/humbja e vitit		73,333,799	517,356,713
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		73,333,799	517,356,713

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Blessed Investment sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra Individuale e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2023	7,000,100	1,053,225,330	390,665,329	1,450,890,759
Transferim në fitime të mbartura	-	390,665,328	(390,665,328)	-
Fitimi i viti	-	-	517,356,713	517,356,713
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	7,000,100	1,443,890,658	517,356,714	1,968,247,472
Transferim në fitime të mbartura	-	517,356,714	(517,356,714)	-
Fitim i vitit	-	-	73,333,799	73,333,799
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	7,000,100	1,961,247,372	73,333,799	2,041,581,271

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra Individuale e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi i vitit	73,333,799	517,356,713
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Amortizimi	12 9,823,940	10,175,927
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
Të ardhura nga dividendët	23 (61,102,183)	(372,421,316)
Të ardhura nga interesi	24 (74,692,582)	(28,686,249)
Shpenzime interesi	24 44,398,278	51,727,563
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(ritje) në investime në proces	(266,585,626)	(460,005,119)
Rënie/(ritje) në të arketueshme të tjera	(207,023,222)	(147,097,324)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	433,848,168	263,963,568
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(47,999,428)	(164,986,237)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e njësive të kontrolluara	85,483	(22,158,201)
Toka për zhvillim	(3,741,000)	202,593,208
Blerje aktive afatgjata	(865,775)	(817,556)
Lëvizje në investimet në huadhënie	(62,494,174)	(475,823,660)
Interesa të arkëtuara	30,294,304	(23,041,314)
Dividendë të arkëtuara	55,386,179	465,555,103
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	18,665,017	146,307,580
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të marra	(166,502,018)	213,190,728
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(166,502,018)	213,190,728
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(195,836,429)	194,512,071
Mjetet monetare në fillim të periudhës	217,404,902	22,892,831
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 21,568,473	217,404,902

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

1. Informacion i përgjithshëm

Blessed Investment sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me NIPT L71423028S, në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Njësinë Bashkiake nr. 2, Rruga "Themistokli Gërmenji", Ndërtesa 1, Tiranë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është zhvillimi i pasurive të paluajtshme, kryerja e operacioneve ekonomike, juridike e financiare si dhe e çdo biznesi që lidhen drejtpërdrejtë ose tërthorazi me realizimin e objektivit të veprimtarisë së shoqërisë, brenda kuadrit të dispozitave ligjore dhe kryerja e çdo aktiviteti të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 7,000,100 Lek dhe zotërohet nga ortakët i vetëm Besnik Leskaj.

Në 31 dhjetor 2024 shoqëria ka 13 punonjës (2023: 9 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale (më poshtë referuar si 'pasqyrat financiare') janë përgatitur në përputhje me politikën kontabël të listuara në shënimin 3, të cilat janë të bazuara në vlerësimin, paraqitjen, dhe parimet kontabël sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), përveç mungesës së konsolidimit të Investimeve në Shoqëritë të Kontrolluara të listuara në shënimin 9. Me poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare individuale.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste Drejtimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Drejtimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2024	2023
Euro/LEK	98.15	103.88
USD/LEK	94.26	93.94

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

Blessed Investment Sh.p.k njeh të gjitha investimet e tij në sipërmarrjet e përbashkëta sipas modelit të koston në pasqyrat financiare individuale të investitorit. Njohja e investimeve bëhet me kosto pakësuar me ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi i njohur në përputhje me SKK 5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

Shpërndarjet e marra nga investimi do të njihen si të ardhura, pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e njësisë ekonomike të kontrolluar bashkërisht të akumuluar para ose pas datës së blerjes.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.5. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës lienare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15% (2023: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe Drejtimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare në bankë	20,881,423	217,404,902
Në lekë	1,097,365	1,965,609
Në monedhë të huaj	19,784,058	215,439,293
Mjete monetare në arkë	687,050	-
	21,568,473	217,404,902

5. Huadhënie ndaj palëve të lidhura

Huadhëniet ndaj palëve të lidhura afatgjatë dhe afatshkurtër më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Huadhënie afatshkurtër	312,521,596	358,375,402
Hua Albanian Financial Institution	42,443,914	76,605,191
Hua GBI shpk	33,979,456	32,258,396
Hua Renew shpk	2,944,500	-
Hua ARC shpk	54,400,063	12,465,600
Hua Abkons Doo	-	16,620,800
Hua Ikons Global Malta	2,014,234	2,131,825
Hua Ikons Doo	5,349,175	4,466,840
Hua ASDC shpk	23,546,185	19,113,920
Hua Orderoo shpk	18,354,050	18,179,000
Hua MOI	4,506,054	6,966,297
Hua Amor Bistro Bar	-	2,100,000
Hua Matrix Konstruksion	68,705,000	72,716,000
Hua Armen Solar shpk	7,852,000	2,077,600
Hua RPAY shpk	19,829,981	7,483,256
Hua InnovFin	3,337,100	-
Hua Hometech shpk	8,342,750	-
Hua EHMKG shpk	790,108	-
Hua afatshkurter SPV Blue 1	16,127,027	85,190,677
Huadhënie afatgjatë	1,220,083,316	1,111,735,328
Hua afatgjatë – Ikons shpk	-	6,856,080
Hua afatgjatë SPV Blue 1 shpk	1,164,249,138	1,097,103,502
Hua afatgjatë SPV Blue 2 shpk	55,834,178	7,775,746
	1,532,604,912	1,470,110,730

6. Tatime të parapaguara

Tatime të parapaguara më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime për tatim fitimin	25,707,141	-
Parapagime për tatimin në burim	700,734	-
	26,407,875	-

7. Aktive të prodhuara për shitje

Aktivitet e prodhuara për shitje më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Situacione ndërtimi nga investitorë	849,860,025	583,274,409
Taksa e bashkisë dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë	130,095,362	130,095,362
	979,955,387	713,369,771

8. Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura

Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime për ndërtimin	288,256,299	214,913,435
Të drejta nga InnovFin GmbH	3,455,831	-
Të drejta ndaj Abkons Shpk	7,361,250	-
	299,073,380	214,913,435

9. Të tjera të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Dividentë të arkëtueshëm	228,093,661	233,809,665
Kliente të tjerë	99,798,420	23,394,571
Llogari të tjera të arkëtueshme	9,678,722	9,685,723
Shpenzime të periudhave të ardhshme	6,808,682	8,530,317
Parapagime për toka	36,500,000	3,116,400
Parapagime të tjera	200,000	371,402
	381,079,485	278,908,078

10. Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje

Investime në shoqëri të kontrolluara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aksione Abkons shpk	116,164,222	116,164,222
Aksione Ikons shpk	900	900
Aksione Abkons Doo	-	1,038,800
Aksione Ikons Doo	981,500	1,038,800
Aksione Blessed Investment Ltd	117,780	124,656
Aksione GBI shpk	50,000	50,000
Aksione ASDC shpk	30,000	30,000
Aksione SPV Blue 1 shpk	510,000	510,000
Aksione SPV Blue 2 shpk	510,000	510,000
Aksione RPAY shpk	25,000,000	25,000,000
Aksione InnovFin GmbH	2,266,059	2,266,059
Aksione Go Teacher	6,035,227	6,035,227
Aksione Armen Solar shpk	30,000	30,000
Aksione Orderoo shpk	20,000	20,000
Aksione MOI	14,046,335	14,046,335
Aksione EHMKG shpk	1,017,494	-
	166,779,517	166,864,999

10. Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje – (vazhdim)

Të dhënat mbi Investime në shoqëritë e kontrolluara dhe pjesëmarrje detajohen më poshtë:

Emri	Adresa	Aktiviteti Kryesor	% e pjesëmarrjes
Aksione Abkons shpk	Rruga "Themistokli Gërmenji, Ndërtesa Nr.6, Tiranë, Shqipëri	Shërbime konsulence inxhinierike	70%
Aksione Ikons shpk	Rruga "Dervish Hima", Ada Tour Nr1, Tiranë, Shqipëri	Shërbime dhe konsulencë ne fushën e IT/ zhvillim software	75%
Aksione Ikons Doo	Bulevar Kralja, Aleksandra 18, Beograd-racar, Serbi	Shërbime dhe konsulencë ne fushën e IT/ zhvillim software	100%
Aksione Blessed Investment LTD	35, STRAIT Street, Valletta VLT,1434, Malta	Investime ne sektorin e ICT	100%
Aksione GBI shpk	Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, Tiranë, Shqipëri	Trajnime për sigurinë teknike dhe rrugore	50%
Aksione ASDC shpk	Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr 18/2, Tiranë, Shqipëri	Investim në pasuri të paluajtshme	30%
Aksione SPV Blue 1 shpk	Rruga "Themistokli Gërmenji, Ndërtesa Nr.1, Tiranë, Shqipëri	Prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike fotovoltaike	51%
Aksione SPV Blue 2 shpk	Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr 18 /2, Tiranë, Shqipëri	Prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike fotovoltaike	51%
Aksione RPAY shpk	Rruga 'Frang Bardhi' Godina Kristal Center	Shërbime informatike në sektorin financiar bankar	20%
Aksione Armen Solar shpk	Rruga "Themistokli Gërmenji" Nd 1,Tiranë, Shqipëri	Shërbime në fushën e zhvillimit dhe prodhimit të energjisë elektrike	30%
Aksione MOI	Amagertov 11 DK-1160 Kobenhaven	Muzeu i iluzioneve	3.48%
Aksione InnovFin	c/o excent AG, Gartenstrasse 7	Shoqëri "Holding" investime ne shoqëri te kontrolluara dhe pjesëmarrje	100%
Aksione Orderoo shpk	Rruga Frank Bardhi, Qendra Kristal, Tiranë, Shqipëri	Shërbime teknologjike të informacionit	20%
Aksione European Hotel Managemen Group Sh.p.k.	Rruga "Themistokli Gërmenji", Nd. 1, Tiranë, Shqipëri	Planifikimi dhe zhvillimi i hotelit	33%

11. Aktive te mbajtura per investim

Aktive te mbajtura për investim konsistojnë ne toka për zhvillim dhe analizohen si më poshtë.

	Toka, troje dhe terrene
Gjendja më 1 janar 2023	404,410,780
Shtesa	-
Transferime	-
Pakësime	(202,593,208)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	201,817,572
Shtesa	-
Transferime	3,741,000
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	205,558,572

Blessed Investment sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2024
(Vlerat janë në Lek)

12. Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023:

Kosto	Ndërtesa	Mobilje e pajisje zyre	Pajisje informatike	Investime zyre	Instalime teknike	Totali
Gjendja më 1 janar 2023	199,058,756	843,027	1,077,691	6,048,834	1,050,772	208,079,080
Shtesa	-	391,838	128,574	149,119	148,035	817,566
Gjendja më 31 dhjetor 2023	199,058,756	1,234,865	1,206,265	6,197,953	1,198,807	208,896,646
Shtesa	-	-	865,775	-	-	865,775
Gjendja më 31 dhjetor 2024	199,058,756	1,234,865	2,072,039	6,197,953	1,198,807	209,762,421
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2023	13,892,642	104,162	162,650	178,405	157,616	14,495,475
Amortizimi i vitit	9,258,306	195,858	240,308	300,357	181,098	10,175,927
Gjendja më 31 dhjetor 2023	23,150,948	300,020	402,958	478,762	338,714	24,671,402
Amortizimi i vitit	8,795,392	210,170	360,496	285,367	172,513	9,823,938
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	31,946,340	510,190	763,454	764,129	511,227	34,495,340
Vlera neto konfabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2023	175,907,808	934,845	803,307	5,719,191	860,093	184,225,244
Gjendja më 31 dhjetor 2024	167,112,416	724,675	1,308,586	5,433,824	687,579	175,267,080

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Furnitorë në lekë	30,852,374	108,764
Furnitorë në monedhë	<u>7,060,143</u>	<u>5,510,790</u>
	<u>37,912,517</u>	<u>5,619,554</u>

14. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Hua ndaj palëve të lidhura	74,834,500	21,310,400
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	<u>231,221,313</u>	<u>194,871,865</u>
	<u>306,055,813</u>	<u>216,181,265</u>

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	628,772	432,163
Tatimi mbi të ardhurat personale	716,920	401,664
Tatimi mbi vlerën e shtuar	530,312	38,251
Tatim fitimi	-	2,376,261
Tatim në burim	<u>76,822</u>	<u>80,915</u>
	<u>1,952,826</u>	<u>3,329,254</u>

16. Parapagime të marra

Parapagime të marra më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime Akses Tirana	770,655,133	459,600,753
Parapagime të marra për qira	<u>1,432,000</u>	<u>1,432,000</u>
	<u>772,087,133</u>	<u>461,032,753</u>

Blessed Investment sh.p.k**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Vlerat janë në Lek)***17. Të tjera detyrime**

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Interesa të përllogaritura Fibank	9,107,633	7,104,928
Paga dhe shperblime	1,758,778	1,758,778
	10,866,411	8,863,706

18. Hua të marra nga bankat

Huamarrja afatgjatë më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Hua e marrë nga Fibank	415,451,163	503,864,728
Hua e marrë nga OTP	202,387,547	280,476,000
	617,838,710	784,340,728

Klasifikimi sipas kohëzgjatjes

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Hua të marra nga bankat- pjesa afatshkurtër	118,279,688	130,432,575
Hua të marra nga bankat - pjesa afatgjatë	499,559,022	653,908,153
	617,838,710	784,340,728

19. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 7,000,100 Lek dhe zotërohet nga ortaku i vetëm Besnik Leskaj.
 Kapitali më 31 dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Numri i kuotave	1	1
Vlera nominale	7,000,100	7,000,100
	7,000,100	7,000,100

20. Të ardhurat

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga shitja e sipërfaqeve të ndërtimit	60,857,075	52,029,208
Fitim nga aktive të mbajtura për investim	-	269,108,326
Të ardhura të tjera	48,922,044	27,269,674
	109,779,119	348,407,208

21. Të tjera shpenzime

Shpenzime të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Konsulence ligjore/financiare	8,640,079	11,887,434
Shpenzime qiraje	6,299,020	6,822,682
Shërbime të tjera	799,956	7,503,278
Shpenzime telekomunikacioni	452,910	529,293
Mirëmbajtje dhe riparime	286,897	386,318
Siguracione	985,440	701,332
Komisione bankare	532,759	383,158
Taksa/ tarifa vendore	-	127,014
Shpenzime të tjera	6,547,063	6,767,935
Gjoha	-	123,209
Kancelari	281,466	101,384
Shpenzime udhëtimi	8,990,113	7,674,826
Sponsorizim	24,103	311,308
Utiliteti	468,741	492,165
Antarësime	724,714	1,630,197
Aplikime	769,180	-
Shpenzime përfaqësimi	1,045,817	-
	36,848,258	45,441,533

22. Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Shpenzime për paga	25,557,264	15,034,180
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	3,315,652	1,864,503
	28,872,916	16,898,683

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2024 është 13 punonjës (31 dhjetor 2023:9 punonjës)

23. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse

Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga dividendët në shoqëritë ku është aksionar	61,102,183	372,421,316
	61,102,183	372,421,316

24. Të ardhura/(shpenzime) financiare (neto)

Shpenzimet financiare(neto) detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga interesat	74,692,582	28,686,249
Shpenzimet për interesa	(44,398,278)	(51,727,563)
Humbje nga këmbimet valutore, neto	(49,817,104)	(82,113,886)
	(19,522,800)	(105,155,200)

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2024 dhe 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
A Fitimi para tatimit	75,813,388	543,157,181
Total shpenzime të panjohura	1,819,391	1,267,257
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime		123,209
Shpenzime të panjohura	1,819,391	1,144,048
Te ardhurat e patatueshme:		
Te ardhura nga dividendët	(61,102,183)	(372,421,316)
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzime te panjohura)	16,530,596	172,003,122
Humbje fiskale të mbartura	-	-
Fitimi para Tatimit	16,530,596	172,003,122
Norma tatimore	15%	15%
B Tatim fitimi	2,479,589	25,800,468
A - B Fitimi i vitit	73,333,799	517,356,713

Blessed Investment sh.p.k**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Vlerat janë në Lek)***26. Transaksionet me palët e lidhura**

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet, si dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Dividend për t'u shpërndarë				
Abkons shpk	174,692,189	-	198,393,540	-
Ikons shpk	31,992,294	-	4,374,883	-
Blessed Investment Ltd	21,409,183	-	31,041,242	-
Besnik Leskaj	-	78,252,459	-	82,008,099
Te drejta/detyrime				
Matrix Konstruksion shpk	265,602,012	108,480,299	291,930,254	115,776,577
Besnik Leskaj	-	61,834,500	-	8,310,400
Ikons Global Ltd	2,014,234	-	2,131,825	-
GBI shpk	33,979,456	-	32,258,396	-
Abkons Doo	-	-	16,620,800	-
Albanian Financial Institution	46,365,940	30,000,000	79,442,233	-
Ikons shpk	-	-	6,856,080	-
ARC shpk	59,295,970	13,000,000	14,763,115	13,000,000
SPV Blue 1 shpk	1,229,593,947	-	1,195,105,041	-
SPV Blue 2 shpk	65,821,942	-	7,775,746	-
ASDC shpk	25,014,112	-	19,873,205	-
Rpay shpk	20,367,018	-	7,668,379	-
Armen Solar shpk	8,106,504	30,000	2,165,700	-
Orderoo shpk	18,371,438	-	18,179,000	-
Amor Bistro Bar shpk	-	-	2,100,000	-
MOI	4,506,054	-	6,966,297	-
Ikons Doo	5,373,253	-	4,466,840	-
EHMG shpk	836,109	-	-	-
Renew Sh.p.k.	3,029,705	-	-	-
Abkons Sh.p.k.	7,361,250	-	-	-
InnovFin	6,927,609	-	-	-
Ikons Global Limited UK	8,374,501	-	-	-
Hometech shpk	8,845,995	-	-	-
Blessed Investment Ltd	11,679,850	48,830,255	-	-
Total	1,831,466,897	262,175,054	1,708,302,910	137,086,977
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Abkons	-	-	-	-
Albanian Financial Institution	5,694,586	30,000,000	4,753,362	-
Matrix Konstruksion	4,577,127	267,423,911	4,300,819	460,891,350
	10,271,713	297,423,911	9,054,181	460,891,350

27. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2024 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

28. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.